



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**



Nr 114 PROT. DATË 04.03.2020

Nr 51 PROT. DATË 04.03.2020

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

DHE

URDHRIT TË MJEKËVE TË SHQIPËRISË

PREAMBUL

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, të cilat në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

- *Duke vlerësuar* përmirësimin e pozitës së pjesëtarëve të diasporës dhe mbrojtjes së drejtave e interesave të tyre nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve dy a më shumë palëshe;
- *Me dëshirën* për të nxitur forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit të përbashkët të palëve në interes të diasporës shqiptare;
- *Për të nxitur* rrjetëzimin e profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë;
- *Me synimin* për të organizuar aktivitete dhe veprimtari shkencore mbi shkëmbimin e eksperiencave dhe arritjeve në fushën e shëndetësisë në diasporën shqiptare;
- *Duke afirmuar vullnetin* dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e këtij Memorandumi për të përmbushur angazhimet në kuadër të Ligjit Nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe Ligjit Nr.123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”.

Palët bien dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandumi.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është nxitja e bashkëpunimit midis Palëve për rregjistrimin dhe krijimin e lidhjeve me profesionistët shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë. Ai synon nxitjen e veprimtarive të përbashkëta dhe ofrimit të kontributit për vendlindjen të mjekëve të cilët ushtrojnë profesionin në diasporë.

Neni 2 Objekti i bashkëpunimit

Palët angazhohen, në përputhje me kompetencat dhe fushat e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunojnë për:

- a. Krijimin e komunikimit midis profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë;
- b. Organizimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet mjekëve shqiptarë në Shqipëri dhe atyre në diasporë;
- a. Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm.

Neni 3

Përgjegjësitë e palëve

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet si vijon:

Agjencia Kombëtare e Diasporës në përputhje me fushën e veprimtarisë se vet por pa u kufizuar angazhohet të realizojë:

- a. Krijimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave mbi mjekët shqiptarë që ushtrojnë profesionin e tyre jashtë vendit;
- a. Nxitjen e politikave të bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me shqiptarët që ushtrojnë profesionin në fushën e mjekësisë jashtë Shqipërisë;
- b. Mbështetjen në hartëzimin dhe rrjetëzimin e profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë në diasporë.

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë në përputhje me fushën e veprimtarisë se vet por pa u kufizuar merr përsipër të realizojë,:

- a. Evidentimin e mjekëve shqiptarë të cilët kanë studiuar jashtë dhe janë rikthyer në Shqipëri;
- b. Organizimin e konferencave apo veprimtarive shkencore në zbatim të këtij Memorandumi;
- c. Bashkëpunimin në publikimin dhe botimin e artikujve shkencorë të paraqitur në veprimtaritë shkencore të realizuara nga palët.

Neni 4

Vlerësimi i zbatimit të Memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë një viti kalendarik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në

formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike.

2. Palët angazhohen të jenë të bashkëpunojnë në koordinim me njëra-tjetrën me qëllim ndërmarrjen e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti në funksion të qëllimit të këtij Memorandumi.

Neni 6 Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 7 Kohëzgjatja dhe ndryshimi

Memorandumi lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Ky Memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9 Hyrja ne Fuqi

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Memorandumi nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale

Nënshkruar në Tiranë, në 04.03.2020.

**AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS
DREJTOR EKZEKUTIV
ELONA BANO**

**URDHRI I MJEKËVE TË SHQIPËRISË
PRESIDENT I KËSHILLIT KOMBËTAR
FATMIR BRAHIMAJ**